



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Prill 2021

Nr: 251

VENDIM

PËR NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË VULËS SË KZAZ-SË NR.69, QARKU KORÇË DHE ZËVENDËSIMIN ME VULË REZERVË

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 99, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 14 pika 2, shkronja “k”, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr.5 datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N

Referuar nenit 14, pika 2 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, sekretari i KZAZ-së është përgjegjës për administrimin dhe përdorimin e vulës së KZAZ-së, dhe njoftimin e menjëhershëm të rasteve të dëmtimit apo humbjes së vulës së KZAZ-së.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr.69, Qarku Korçë, me shkresën nr.3901prot., datë 17.04.2021, ka njoftuar KQZ-në, për humbjen e vulës, dhe zëvendësimin e saj me vulë rezervë. Arsyeya e referuar nga KZAZ-ja nr.69 për humbjen e vulës, është zhvendosja e zyrës së ZAZ-së ne ambientet e VNV-së, dhe pas zhvendosjes nuk arrin ta gjej vulën e humbur.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 99, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 14 pika 2, shkronja “k”, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr.5 datë 20.11.2020 “Për miratimin e rregullores për



organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VENDOSA:

1. Të nxjerr jashtë përdorimit vulën e KZAZ-së nr.69, Qarku Korçë, e prodhuar sipas modelit të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.4, datë 07.01.2021.
2. Të zëvendësoj vulën e KZAZ-së nr.69, Qarku Korçë, me vulë rezervë sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021:

Formati i Vulës: KZAZ



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Numri i Identifikimit: KZAZ- R- 69.
6. tekst: Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021